

## LIGJI PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

L I G J Nr.7870, date 13.10.1994

Ndryshuar me:

Ligin Nr.8005, date 4.10.1995 dhe Ligjin Nr. 8961, date 24.10.2002,Ligjin Nr. 9207 date 15/03/2004, Ligjin Nr. 9368 date 7.4.2005, **Ligi Nr.10043 date 22.12.2008.**

### PER SIGURIMET SHENDETESORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim te Keshillit te Ministrave,

### KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE V E N D O S I :

#### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Perkufizime

Termat:

"**Shtetas**" perfshin gjithe shtetasit e Republikes se Shqiperise."Persona ekonomikisht aktive" perfshin gjithe personat e punesar, te vetepunesuarit, punedhenesit dhe personat me te ardhura te rregullta nga pronat, pasuria e patundshme ose burime te tjera te kahasueshme."Persona te punesar" perfshin gjithe personat e punesar me ose pa kontrate prane nje punedhenesi.

"**Punedhenes**" perfshin gjithe personat fizike e juridike qe marrin ne pune persona te tjere me ose pa kontrate.

"**Punonjes i papaguar i familjes**" perfshin anetaret e familjes mbi 16 vjeç qe punojne e bashkejetojne me te vetepunesuarin dhe nuk kane ndonje punesim tjeter.

"**Punonjes te huaj**" perfshin gjithe shtetasit e huaj qe punojne ne Shqiperi.

"Kontribut" perfshin gjithe parate qe derdhen ne favor te ISKSH (Institutit te Sigurimit te Kujdesit Shendetesor).

"**Mjek i per gjithshem**" eshte mjeku i diplomuar, i pajisur me licence per ushtrimin e profesionit, i cili i jep popullsise kujdesin shendetesor, paresor dhe te vazhdueshem, pavaresisht nga mosha, seksi ose semundja.

"**Mjek i familjes**" eshte mjeku i diplomuar dhe i specializuar si mjek familjeje, i pajisur me licence per ushtrimin e profesionit, i cili i jep popullsise kujdesin shendetesor, paresor dhe te vazhdueshem, pavaresisht nga mosha, seksi ose semundja.

"**Sherbimi nga mjeku i per gjithshem ose i familjes**" perfshin viziten dhe trajtimet e para te thjeshta te kryera nga vete mjeku i per gjithshem ose i familjes.

"**Rrjeti i hapur farmaceutik**" perfshin farmacite dhe depot e barnave.

Neni 2

**Ky ligj rregullon financimin e kujdesit shendetesor.**

Neni 3

Financimi i kujdesit shendetesor

Kujdesi shendetesor financohet nga:

- a) sigurimet shendetesore te detyrueshme;
- b) shteti;
- c) pagesat e drejtperdrejta te shtetasve;
- ç) sigurimet shendetesore vullnetare suplementare.

Neni 4

**Sigurimet shendetesore te detyrueshme**

1. **Sigurimi shendetesor i detyrueshem** mbulon gjithe shtetasit e Republikes se Shqiperise me banim te perhershëm ne Shqiperi, si dhe te huaj e te punesar e te siguruar ne Shqiperi.

2. Sigurimet shendetesore te detyrueshme jane nje sistem jofitimprures qe mbulojne:
  - a) nje pjese te çmimit te barnave ne rrjetin e hapur farmaceutik;
  - b) shpenzimet e sherbimit nga mjeku i per gjithshem ose i familjes, mjeku specialist, infermieret e sherbimit shendetesor paresor per te gjithe te siguruarit.
  - c) sherbimet shendetesore spitalore te miratuar nga Keshilli i Ministrave.
3. Sigurimet shendetesore te detyrueshme sigurohen nga nje institut shteteror i pavarur - Institut i Sigurimit te Kujdesit Shendetesor (me poshte do te quhet ISKSH) dhe mbulojne nje pjese te çmimit te barnave kryesore te listes se miratuar nga Keshilli i Ministrave dhe shpenzimet e sherbimit nga mjeku i per gjithshem ose i familjes, shpenzimet e sherbimeve shendetesore spitalore. Masa e mbulimit percaktohet çdo vit nga Keshilli i Ministrave.
4. Kontributet paguhen nga shtetasit ekonomikisht aktivedhe shteti. Punedhenesit marrin pjese ne kontributet qe paguhen nga vete ata dhe nga punonjesit e tyre. Shteti kontribuon ne ISKSH per popullsine ekonomikisht joaktive dhe per kategori te tjera sipas nenit 8, pika 2 dhe 3 te ketij ligji.

#### **Neni 4/1**

Sigurimet shendetesore vullnetare

Shtetasit mund te sigurohen vullnetarisht ne skemat e sigurimeve vullnetare, kur per nje kohe dhe shkaqe te arsyeshme nuk mund te sigurohen detyrimisht.

Sigurimi vullnetar, i parashikuar nga kjo dispozite, behet ne kushtet e percaktuara nga Rregullorja e Institutit te Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor.

#### **Neni 4/2**

Sigurimet shendetesore suplementare

1. Sigurimet shendetesore suplementare jane nje skeme e sigurimit te detyrueshem per te punesuarit, sipas percaktimit te bere nga ligji nr.8097, date 21.3.1996 "Per pensionet shteterore suplementare te personave qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit".
2. Masa e kontributit qe paguajne personat e siguruar, ne perputhje me nenin 5 te ligjit nr.8097, date 21.3.1996, eshte 1 per qind e shumes bruto te listepagesave.
3. Lloji dhe masa e perfitimeve dhe sherbimeve te mbuluara nga sigurimet shendetesore suplementare caktohen me ligj te veçante.

#### **Neni 5**

##### **Kujdesi shendetesor shteteror**

Shteti financon:

- a) masat shendetesore parandaluese;
- b) viziten dhe ekzaminimet per qellime diagnostikimi nga specialisti, kujdesin shendetesor spitalor, si dhe raste te tjera te percaktuara me ligj;
- c) sherbimet e urgjences;
- ç) investimet.

Shteti kontribuon sipas nenit 34 te ketij ligji.

Sherbimet e urgjences per rastet e jashtezakonshme, si aksidente masive, epidemi dhe fatkeqesi natyrore, organizohen nga bashkite dhe komunat me mbeshtetjen e qeverise per financimin e tyre. Per sherbime te tilla shpenzimet mbulohen sipas kritereve te percaktuara nga Keshilli i Ministrave.

#### **Neni 6**

##### **Pagesat e drejtperdrejte te shtetasve**

Me pagese te drejtperdrejte te shtetasve kuptojme pagesen direkte te nje pjese te çmimit te barnave ne perpesetim me shumen e paguar nga ISKSH, sipas pikes 2, te nenit 4 te ketij ligji.

#### **Neni 7**

##### **Sigurimet shendetesore vullnetare suplementare**

1. Shtetasit mund te sigurojne veteren dhe familjet e tyre vullnetarisht me skema te sigurimeve suplementare per mjekimet me kosto te larta, qe nuk mbulohen nga sigurimet e detyrueshme ose per perfitime te tjera shtese. Shtetasit mund te futen ne sigurimet shendetesore vullnetare suplementare per te mbuluarpagesen e tyre te drejtperdrejte per barnat, çmimet e protezave dhe te xhamave optike, sherbimet dentare dhe sherbimet e tjera

ambulatore, qe nuk mbulohen nga sigurimet e detyrueshme. Sigurimet vullnetare gjithashtu mund t'i sigurojneshtetasve shqiptare mbulimin e shpenzimeve te mjekimit jashte shtetit.

2. Sigurimet shendetesore vullnetare suplementare organizohen nga:

- a) ISKSH;
- b) Shoqatat e ndihmes se ndersjellte te themeluara per kete qellim, si dhe
- c) shoqerite tregtare te sigurimit.

Per pikat b dhe c te ketij paragrafi eshte e domosdoshme qe keto subjekte te jene te regjistruara ne gjykate, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

3. Sigurimi vullnetar nuk subvencionohet nga shteti.

4. Keshilli i Ministrave cakton nje organ qe:

- a) kontrollon veprimtarine e shoqerive te sigurimeve vullnetare suplementare;
- b) mbron interesat e personave te siguar kundrejt pasojave te abuzimeve financiare te siguruesit;
- c) vendos rregullat per shoqerite e ndihmes se ndersjellte, te cilat jane themeluar per sigurimet shendetesore suplementare.

## **II. SUBJEKTET PERGJEGJES PER TE PAGUAR KONTRIBUT**

**Neni 8**

1. Personat ekonomikisht aktive, te punesar e te vetepunesuar ne fshat e ne qytet, punonjesit e papaguar te familjes dhe persona te tjere me te ardhura te rregulla nga pronesia, sipas percaktimit te Keshillit te Ministrave, jane tedetyruar te kontribuojne ne ISKSH.

2. Shteti kontribuon per personat joaktive si:

- a) femijet, nxenesit dhe studentet me shkeputje nga puna;
- b) pensionistet
- c) te paafjet (mendore dhe fizike);
- ç) te papunet;
- d) personat qe trajtohen me ndihme ekonomike dhe asistence sociale
- dh) nenat me leje lindjeje;
- e) shtetasit qe kryejne sherbimin ushtrak te detyruar.

3. Keshilli i Ministrave ka te drejte te specifikoje grupe te tjera shtetasish, per te cilet duhet te kontribuoje shteti, sipas pikes 2 te ketij neni.

**Neni 9**

**Detyrime per te paguar kontribute**

Kontributet paguhen nga:

- a) te punesarit dhe punedhenesit e tyre;
- b) persona te tjere ekonomikisht aktive;
- c) shteti.

## **III. KONTRIBUTET**

**Neni 10**

**1. Kontributet illogariten:**

- a) Ne perqindje mbi pagen per:
  - personat e punesar;
  - te huajt e punesar ne Shqiperi.
- b) Ne mase fikse per:
  - te vetepunesuarit (shqiptare dhe te huaj ne Shqiperi) dhe punedhenesit;
  - punonjesit e papaguar te familjes.
- c) Ne mase fikse per:
  - pjesen qe derdhet nga buxheti i shtetit, sipas nenit 34.

2. Kontributi sipas germes "a" te pikes 1 te ketij neni eshte 3.4 per qind e pages bruto, duke pasur si page minimale e maksimale ate te percaktuar nga Keshilli i Ministrave per kontributet e sigurimeve shoqerore. Pagesa e ketij kontributi ndahet ne menyre te barabarte ndermjet punedhenesit dhe te punesuarit.

3. Kontributi sipas germes "b" pikes 1 te ketij neni eshte:

per te vetepunesuarit, punedhenesit dhe punonjesit e papaguar te familjes ne qytet 7 per qind e pages minimale, siç percaktohet ne piken 2 te ketij neni;

- per te vetepunesuarit dhe punetoret e papaguar te familjes ne fshat kontributi eshte: ne zonen fushore 5 per qind te pages minimale dhe 3 per qind te pages minimale per zonen kodrinore-malore, duke pasur per baze ate te percaktuar nga Keshilli i Ministrave per sigurimet shoqerore.

4. Ministri i Shendetese per raste te vecanta ka te drejte ta ule masen fikse te kontributit per:

a) punonjesit e papaguar te familjes;

b) disa kategori te bujqeve te vetepunesuar.

#### Neni 11

**1.Kontributet ne fondin e sigurimeve shendetesore paguhen çdo muaj.** Afati i pagimit te kontributeve eshte jo me vone se data 25 e muajit pasardhes. Punedhenesi eshte i detyruar te mbaje nga paga kontributin per te punesuarin dhe ta derdhe ate se bashku me kontributin e vet ne organet tatemoreose ne llogarite e Institutit te Sigurimeve Shoqerore. Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve ose Institutit i Sigurimeve Shoqerore, sipas rastit, eshte pergjegjes per transferimin e kontributeve ne Institutin e Sigurimit te Kujdesit Shendetesor.

2. Personat e vetepunesuar paguajne kontributet per veten dhe punonjesit e papaguar te familjes dhe i derdhin ne organin perkates, sipas afateve te percaktuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave.

3. Personi i detyruar per pagesesn e kontributeve te sigurimeve shendetesore dorezon ne organin perkates permblehdjen e kontributeve dhe deklaratene perkatese te pageses, ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne pikat 1 e 2 te ketij neni".

#### Neni 12

##### Sanksionet

1. Te gjithe personat e detyruar per te paguar kontribute per efekt te sigurimeve shendetesore, rregjistrohen ne organet tatemore ose ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore, sipas rastit. Rregjistrimi i te punesuarve behet nga punedhenesi i tyre. Personi qe ka detyrimin per te paguar kontributet pajis çdo punemarres ose punonjes te papaguar te familjes me numrin e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe rregjistron shumat e paguara per se cilin gjate periudhes ne marredhenie pune, qofshin keto ne te holla apo perfitime ne natyre.

2. Nese pagimi i kontributeve nga personat e detyruar nuk behet brenda afatit, mbahen interresat per pageset te vonuar. Masa e interesit eshte ajo e percaktuar ne Ligjin Nr.8560, dt 22.12.1999 " Per procedurat tatemore ne Republiken e Shqiperise" me ndryshimet perkatese".

3. Per vonesa prej 1 muaji ne pagesen e kontributeve I hiqet e drejta shtetasit per mbulimin e çmimit te barnave dhe te shpenzimeve te sherbimit nga mjeku i per gjiththem ose i familjes per periudhen e voneses. Gjobat vendosen nga inspektoret e sigurimeve shoqerore dhe ekzekutimi i tyre behet ne perputhje me ligjin "Per kundervajtjet administrative.

#### Neni 12/1

Kur nuk perbejne veper penale, shkeljet e me poshteme perbejne kundervajtje administrative dhe denohen me gjobe si me poshte:

per mosrregjistrimin e veprimtarise ekonomike ne organet per gjegjes per mbledhjen e kontributeve punedhenesi gjobitet me 60 000 ( gjashtedhjet mijë) leke, ndersa I vetepunesuari me 20 000 ( njezet mijë); çdo person tjeter, qe detyrohet te paguaje kontributet, por qe nuk rregjistrohet ne organin perkates gjobitet me 20 000( njezet mijë);

punedhenesi, qe dorezon me vonese deklaratene e kerkuar sipas ketij ligji gjobitet me 10 perqind te shumes se kontributit te deklaruar me vonese, por jo me pak se 10 000( dhjete mijë ) leke.

ç) çdo person tjeter I detyruar te paguaje kontributet, qe dorezon me vonese deklaratene e kerkuar, siaps ketij ligji, gjobitet me 10 000( dhjete mijë) leke. punedhenesi, qe deklaron kontribute me te uleta gjobitet me 50 perqind te shumes se kontributit te padekluar.

dh) punedhenesi, qe ua mban kontributet punonjesve, por nuk l paguan at one organet perkatese, gjobitet me 50 % te shumes se kontributit te papaguar per çdo muaj. punedhenesi, qe nuk mban rregjistrimet ne perputhje me piken 1 te nenit 12, gjobitet me 30 000 ( tridhjete mije ) leke.

Ne çdo rast gjobat paguhen bashke me kontributet dhe interesat perkates.

Vendosja e gjobave dhe ankimimi I tyre behen ne perputhje me Ligjin Nr.8560, dt, 22.12.1999 " Per procedurat tatile ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar.

Neni 12/2

Te siguruarit jane te detyruar te pranojne kontrollin (verifikimin) nga specialistet e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor per sherbimet e perfituar.

Neni 12/3

Jane kundervajtje administrative:

- Mospranimi i kontrollit nga specialistet e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor;
- perfitimet e padrejta, kur nuk perbejne veper penale.

Shkeljet e mesiperme denohen me:

- a) gjobe deri ne 5 000 leke dhe shperblimin e demit;
- b) heqjen e se drejtës per perfitim nga Sigurimet Shendetesore deri ne 1 muaj. Gjobat vendosen nga specialistet e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor dhe ekzekutimi i tyre behet ne perputhje me ligjin nr.7697, date 7.4.1993 "Per kundervajtjet administrative" me ndryshimet perkatese.

#### **IV. PERFITIMET**

**Neni 13**

**I siguruari perfiton mbulimin e:**

- a) nje pjese te çmimit te barnave sipas pikes 3, neni 4, te ketij ligji;
- b) shpenzimeve te sherbimit nga mjeku i per gjithshem dhe mjeku i familjes.
- c) sherbimet shendetesore spitalore, te miratuara nga Keshilli Ministrave.

**Neni 14**

**Mbulimi i shpenzimeve**

Shpenzimet e sherbimit nga mjeku i per gjithshem ose i familjes mbulohen ne varesi nga numri i personave te regjistruar te ky mjek. Rregullat per percaktimin e mases se shperblimit vendosen nga Keshilli Administrativ i ISKSH-se. Tarifat e sherbimeve te parashikuara ne nenin 4 pika 2 shkronja "c", masa e mbulimit nga sigurimet shendetesore dhe procedurat per mbulimin e shpenzimeve percaktohen me Vendim te Keshillit te Minsitrave".

**Neni 15**

**Masa e mbulimit te çmimit te barnave**

1. Masa e mbulimit te çmimeve te barnave te listes kryesore percaktohet çdo vit nga ISKSH me miratim te Keshillit te Ministrave.
  - 1.a. Lista e barnave qe rimbursohen hartohet nga nje komision teknik i quajtur "Komisioni i Hartimit dhe Rishikimit te Listes se Barnave te Rimbursueshme" dhe nga "Komisioni i Çmimit te Barnave" (KÇB) te ngritur me urdher te Ministrit te Shendetesise. Ne kete komision Shoqata e Grosisteve Farmaceutike ka perfaqesuesin e saj. Kjo liste miratohet nga Keshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit te Shendetesise.
  2. Atje ku ka me shume barna alternative per t'u perdorur ne nje rast, me te njejtin efekt, ISKSH mbulon çmimin e me pak te kushtueshmit. Me te kushtueshmit mund te sigurohen vetem sipas kushteve te percaktuara nga keshilli administrativ i ISKSH.

**Neni 16**

**Kufizimet**

ISKSH nuk mbulon çmimin e protezave dhe te syzeve optike, si dhe nuk siguron asnje shpenzim tjeter shendetesor, me perjashtim te atyre te parashikuara ne kete ligj dhe te percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave.

#### **V. ORGANIZIMI DHE DREJTIMI**

## **Neni 17**

Sigurimet shendetesore ne Republiken e Shqiperise organizohen e drejtohen nga Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor. ISKSH eshte nje institucion shteteror i pavarur, i cili ka administraten e vet, ne qender e ne rreth.

## **Neni 18**

### **Statuti**

Organizimi dhe veprimtaria e ISKSH drejtohen mbi bazen e nje statuti te miratuar nga Keshilli i Ministrave, me propozim te Ministrise se Shendetesise dhe ISKSH.

## **Neni 19**

### **Drejtimi**

ISKSH drejtohet nga:

- a) keshilli administrativ;
- b) drejtori i per gjithshem.

## **Neni 20**

### **Keshilli Administrativ**

1. Keshilli Administrativ eshte organi me i larte ekzekutiv dhe perbehet nga 11 anetare, prej te cileve:

a) Tre anetare te caktuar nga Keshilli i Ministrave, qe perfaqesojne:

- Ministrine e Shendetesise;
- Ministrine e Punes, Emigracionit dhe Perkrahjes Sociale;
- Ministrine e Financave dhe

Nje anetar nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore

Nje anetar nga Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor.

b) Dy perfaqesues: nje nga sindikata qe ka numrin me te madh te anetareve dhe nje nga organizata me e madhe e bujqve.

c) Kater perfaqesues te paleve te interesuara: nje nga urdhri i mjekeve, nje nga nje organizate punedhenesish, nje nga prodhuesi me i madh farmaceutik ne Shqiperi dhe nje nga shoqata e farmacisteve.

2. Keshilli i Ministrave deklaron se cila sindikate, organizate bujqish e punedhenesish eshte me e madhja dhe cili eshte prodhuesi me i madh farmaceutik, qe emerojne perfaqesuesit e tyre ne Keshillin Administrativ.

3. Sipas deklarimeve te Keshillit te Ministrave, organizatat e mesiperme emerojne anetaret e Keshillit Administrativ. Afati i sherbimit ne keshill eshte 4vjet.

## **Neni 21**

### **Kryesia e Keshillit Administrativ**

Keshilli Administrativ zgjedh me votim te fshehte kryetarin dhe dy zevendeskryetaret e tij.

## **Neni 22**

### **Kompetencat e Keshillit Administrativ**

Keshilli Administrativ ka keto kompetencia:

- a) Propozon emerimin dhe shkarkimin e drejtorit te per gjithshem.
- b) Miraton per çdo vit programin e paraqitur nga drejtori i per gjithshem, raportin, bilancin, buxhetin vjetor dhe perspektivat trevjeçare te skemes se sigurimeve shendetesore.
- c) Propozon ne Ministrine e Shendetesise dhe ne ISSH ndryshimet ne statutin e ISKSH dhe ne ligjin e sigurimeve shendetesore;
- c) Vendos per lidhjen e marreveshjeve dhe kontratave te rendesishme.
- d) Miraton rregulloret e propozuara nga drejtori i per gjithshem, qe kane te bejne me çeshtje financiare.

- dh) Miraton komitetin e kontrollit per veprimtarine e ISKSH.
- e) Miraton rregulloret e ISKSH lidhur me organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, kur eshte ngarkuar nga ky ligj.
- e) percakton dhe miraton strukturen dhe numrin e punonjesve te ISKSH, si dhe pagat e tyre.

#### **Neni 23**

##### **Kompetencat e drejtorit te per gjithshem**

Drejtori i per gjithshem i ISKSH emerohet dhe shkarkohet nga Ministri i Shendetesise dhe i Mbrojtjes se Ambientit me propozim te Keshillit Administrativ dhe:

- a) drejton veprimtarine e ISKSH;
- b) raporton çdo vit per veprimtarine e ISKSH ne Keshillin Administrativ;
- c) emëron zëvendësrejtorin e përgjithshem dhe drejtoret e ISKSH;
- ç) percakton rregulloren e brendshme te ISKSH;
- d) emeron punonjesit e ISKSH dhe kryetaret e degeve ne rrethe,
- dh) vendos per te gjitha çeshtjet e administrimit te ISKSH dhe raporton para keshillit administrativ per veprimtarine e tij;
- e) propozon ne keshillin administrativ buxhetin e ISKSH, planin financiar dhe paraqet reportin vjetor, parashikimin per tre vjet dhe rregulloret e ISKSH lidhur me kontributet dhe problemet financiare.
- e) Percakton dhe miraton strukturen e punonjesve te ISKSH-se, si dhe pagat e tyre.

#### **Neni 24**

##### **Ministri i Shendetesise**

1. Ministri i Shendetesise eshte per gjegjes per drejtimin e politikes shendetesore te ISKSH. Keshilli Administrativ i paraqet ministrit te Shendetesise:
  - a) reportin vjetor dhe bilancin;
  - b) projektbuxhetin per vitin pasardhes;
  - c) parashikimin e shpenzimeve per tre vjetet e ardhshem.
2. Ministri i Shendetesise, ne baze te propozimit te Keshillit Administrativ te ISKSH, shqyrton:
  - a) amendamente ne ligjin e sigurimeve shendetesore;
  - b) projektvendime per ne Keshillin e Ministrave;
  - c) akte te tjera nenligjore.

#### **Neni 25**

##### **Instituti i Sigurimeve Shoqerore**

1. Instituti i Sigurimeve Shoqerore eshte per gjegjes per:
  - a) mbledhjen e kontributeve per llogari te buxhetit te ISKSH;
  - b) regjistrimin e te gjithe personave te siguruar, sipas skemes se sigurimit te detyrueshem dhe vullnetar, te percaktuar nga ky ligj, dhe pajisjen me karten e sigurimit dhe me numrin e identitetit.
2. Fondet e mbledhura derdhen ne buxhetin e ISKSH brenda dates 15 te muajit te ardhshem.
3. Instituti i Sigurimeve Shoqerore i paraqet çdo vit ISKSH nje raport per veprimet e tij sipas ketij ligji.

## **VI. ADMINISTRIMI**

#### **Neni 26**

##### **Administrimi**

Administrimi perfshin mbulimin e nje pjese te çmimeve te Barnave, te sherbimit shendetesor paresor, si dhe te sherbimeve shendetesore spitalore.ISKSH-ja lidh kontrate me farmacite, depot e barnave dhe me mjeket e familjes qe plotesojne kriteret e vendosura nga Keshilli Administrativ. Kjo kontrate eshte kontrate mes paleve, ku parashikohen te drejtat dhe detyrimet reciproke.Nje pjese e çmimit te barnave sipas nenit 15, pika 1, te ketij ligji dhe shpenzimet e sherbimeve nga mjeku i per gjithshem ose i familjes, per farmacite , depot e barnave dhe mjeket e per gjithshem a te familjes, qe kane kontrate me ISKSH, mbulohen nga buxheti i ISKSH.ISKSH vepron nepermjet

nje rrjeti nepunesish te rretheve. Per barnat, administratori i rrethit mbulon shpenzimet ne baze te dokumentacionit te shpenzimeve faktike mujore ose dyjavore te paraqitura nga farmacite. Per mjekun e per gjithshem ose te familjes administratori i rrethit mbulon çdo muaj shpenzimetne baze te numrit te personave te regjistruar te mjeku i per gjithshem ose i familjes. Detyrat e administratorit percaktohen ne rregulloren e ISKSH. Procedurat e hollesishme te administrimit percaktohen me akte te Keshillit te Ministrave. ISKSH-ja, nepermjet drejtiveve rajonale, lidhe kontrate me drejtuesit e spitaleve, te cilet jane per gjegjes per permbushjen e detyrimeve kontraktore, ne kuader te financimit te sherbimit spitalor nga skema e sigurimeve shendetesore.

#### Neni 26/a

Farmacite dhe mjeket e familjes ose te per gjithshem permisbatim te kontrates paguajne gjobe ne masen nga 1 000 deri ne 10 000 leke. Gjobat vendosen nga specialistet dhe drejtuesit e Institutte Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor dhe te degeve te varesise se tij ne rrethe. Ekzekutimi i tyre behet ne perputhje me ligjin Per kundervajtjet administrative.

#### Neni 27

##### **Regjistrimi dhe identifikimi**

1. Personat e siguruar me ligjin e Sigurimeve Shoqerore jane automatikisht:
  - a) te regjistruar per Sigurimet Shendetesore Kombetare;
  - b) per gjegjes per te paguar kontributet e sigurimeve shendetesore.
2. Identifikimi i personave te tjere qe pershkruhen ne nenin 8, pika 2, percaktohet me vendim te Keshillit te Ministrave.

#### Neni 28

##### **Mbledhja e kontributeve**

Mbledhja e kontributeve te sigurimeve shendetesore I kalon si funksion Drejtorese se Pergjitheshme te Tatimeve ne perputhje me fazat e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave. Personat qe kane detyrimin per te paguar kontributet do te vazhdojne te derdhin kontributet e sigurimeve shendetesore bashke me kontributin e sigurimeve shoqerore ne Institutin e Sigurimeve shoqerore, deri ne çastin qe, me Vendim te Keshillit te Ministrave, mbledhja e kontributeve do te behet nga organet tatimore.

#### Neni 29

##### **Pagesa e perfitimeve**

Personat e punesar dhe personat ekonomikisht aktive kane te drejten e mbulimit te shpenzimeve qe percaktohen ne kete ligj, pasi te vertetojne se kane paguar kontribute sipas afateve te percaktuara ne kete ligj.

Pagesa e kontributeve vertetohet nga nje karte sigurimi qe u jepet:

- a) personave te punesar per periudhen e punesimit;
- b) personave te vetepunesuar dhe punedhenesve.

#### Neni 30

##### **Ankimet**

1. Cilido subjekt i pershkruar ne kete ligj ka te drejten e ankimit ne ISKSH ndaj veprimeve te administratorit te ISKSH ne rreth, qe lidhen me mbulimin e shpenzimeve.
2. Ankimi kunder vendimit te ISKSH zgjidhet nga gjykata kompetente.

## **VII. FINANCFIMI**

#### Neni 31

Shteti garanton fondin e ISKSH ne rast falimentimi.

#### Neni 32

##### **Fondi rezerve**

çdo tejkalim i kontributeve mbi perfimet ruhet ne nje fond rezerve, i cili perdoret sipas kriterieve financiare te percaktuara ne statut.

**Neni 33****Buxheti i ISKSH**

1. Ne buxhetin e ISKSH-se parashikohen te ardhurat, shpenzimet per barnat, shpenzimet per sherbimin shendetesore paresor, shpenzimet per sherbimet shendetesore spitalore, te percaktuara nga Keshilli i Ministrave, si dhe shpenzimet administrative.
2. Buxheti i ISKSH paraqitet nga Ministria e Shendetese ne Keshillin e Ministrave dhe ne Kuvendin Popullor, se bashku me buxhetin e shtetit.

**Neni 34****Kontributi i shtetit**

Kontributi i shtetit per personat ekonomikisht joaktive te percaktuар ne nenin 8, pika 2, bazohet ne konsumin per fryme te sherbimit shendetesor qe parashikon ky ligj. Konsumi per fryme per sherbimin shendetesor percatohet nga ISKSH dhe miratohet nga Kuvendi Popullor, se bashku me buxhetin e shtetit. Per vitin e pare te zbatimit te ligjit, kontributi i shtetit ne ISKSH eshte subvencioni i çmimeve te barnave dhe pjesa e planifikuar e fondit te pages se mjekut te pergjithshem nga buxheti i shtetit per Ministrine e Shendetese.

**IX. PROCEDURAT****Neni 35**

1. ISKSH nxjerr udhezime per procedurat qe duhet te ndiqen per mbulimin e shpenzimeve.
2. ISSH-ja nxjerr udhezimet perkatese per procedurat e rreghistrit dhe te pageses se kontributeve per subjektet qe do te vazhdojne t'I derdhin kontributet ne kete institucion"

**X. DISPOZITA PERFUNDIMTARE DHE TE TRANZICIONIT****Neni 36**

Keshilli i Ministrave nxjerr aktet nenligjore per zbatimin e ketij ligji.

**Neni 37**

Skema hyn ne fuqi me 1 mars 1995.

**Neni 38**

çdo dispozite qe bie ne kundershtim me kete ligj, shfuqizohet.

**Neni 39**

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.